


# AGIM SHEHU

BIBLIOTEKA

SSH-1

Sh 30



## POEZI

# arkitektura e zemres

8JA-1  
5430

**AGIM SHEHU**

**ARKITEKTURA E  
ZEMRËS**



54050

**- Tiranë 1994 -**

## FRYMA E SHTËPISË NË FSHAT

Hyra në shtëpinë e lindjes  
që rrinte pa njeri brënda.  
Nëpër trarët e shtëpisë  
si mëndafsh i butë ajri  
endej frymë e gjyshes sime  
që iku kur s'kisha lerë.  
Te hiri shuar në vatër  
flinte jeta e këputur  
e aq brezave nga fisi.  
Nëpër dhomat pa njeri  
venë e vinë pa biseduar  
ata që s'janë më në jetë.

Nëpër pllakat e oborrit  
bari që njeri s'e shkelte  
çelte për inat të vdekjes.  
Prilli mbi degët e ftoit  
ulte hënën në çdo lule.  
Zogu që ulej pa frikë  
në parvazin e dritares,  
dyerve që nuk lëviznin  
u kërkonte kalamanët.  
Isha larg e isha burrë.  
Në dhomat me sy të shqyer  
muret donin frymë njeriu  
të ngjiteshin ku qenë çarë.  
Macja e vetme e gjitones  
në oborr ecte pa qejf  
se s'shihte njeri ta trëmbte.

Një gozhdë ngulur në mur  
ndryshkej nga malli për rroba.  
Rezja që hynte në dhomë  
nga të çarat e çatisë  
kontrollonte herë pas here  
mos dikush që ngjallur brënda.  
Vërshëlleva pak me vete, -  
s'di ç'u zgjua brënda dhomës  
dhe muret mësuar heshtur  
bubullinë për të rënë.

## UDHËT NË PLLAJË TË MALIT

*-shqiptarët -*

Udhët te pllaja në zall  
mblidhen kryq tërthor nga shpati.  
Secilën nga to në mal  
një kokë me vete e hapi :

Atë udhë të sertë tërthore  
një malsor nisur për sherre  
e hapi me majë të shollëve  
nëpër shkëmb e ferrë pas ferre.

Tjetrën udhë të butë mes bari  
si me vijë të lëmuar,  
e hapi ëmbël stanari  
kur kthehej në fshat te gruaja.

**Atë rryp mbi zall të bardhë  
e çau dikush drejt shkrepit  
( larguar nga udhë e parë  
meqë e kish hapur tjetri ).**

**Veç e veç si karaktere,  
udhë e dytë mënjanë së parës ....  
( Te gryka në buzë humnere  
bëhen një përballë ujvarës ).**

## **E VJETRA URË E FËMIRISË**

**Urë e fëmirisë së brishtë !**

**Na shihje që nga larg tek vareshim sovranë :  
kalorës - zbathur,  
përmbi brekë këmishët.  
me nga një shkop në dorë si jataganë.**

**Në xhëp pak bukë. Erë qepe e rigoni.  
Trupa të lehtë fëmijësh të cfilitur.  
Tek hidheshim me kokë,  
në ajër riprodhonim  
harqet e këmbëve që të qenë mbytur.**

**Mbi një kaçubë rrobat peng t'i linim .  
Dielli mbi ujë dridhej si monedhë.  
Ne zgjateshim "me pushë" ta cingnim ....  
Po në pëllëmbë  
s'na ndënji asnjëherë !**



**Rrinim mbi pllaka posi zogj të lagur.  
Shihnim me dhimbje  
pellgun tharë nga vapa !  
Ujin e flokëve ia dhuronim avull  
një reje varur mbi ujrat e pakta.**

## **LIBRI I PARË NË VITRINË.**

**Një cep vitrine në librari  
zuri libri im i parë dikur.  
Volumet e trasha shikonte përbri  
si gjimnazistja  
komisionin në maturë !**

**Sovrane, me zymti fytyre  
rrinin volumet me lavditë mbi supe.  
As e vunë re  
se në këmbët e tyre  
hyri gjimnazistja ime e turpshme.**

**Me modernët - viganë  
s'i shkante nër mënd të ngrëjë gotë një grimë.  
Kokulur, kërkonte t'u rrinte pranë  
këmbanave të tyre  
t'u shtojë një psherëtimë.**

Këmbëkryq Majakovski gjëmonte, gajasej ....  
Dridheshin xhamat nga çdo metaforë.  
Kafshonte buzët libri im  
e sprapsej,  
me një lule Esenini në dorë.

Dëgjonte përleshje "shkollash", poetësh,  
debate arti me fraza të thella:  
Vargun e lirë shanin sonetat  
thua, do t'i thyenin një notë  
nga sjellja !

Skuqej libri im, zbehej.  
Mbi purpurin e faqeve i djersisnin naivitetet.  
Kish dalë nga bangat  
e atje desh të kthehej,  
Dhe u lutej shkollarëve - "më merrni me vete ! "

## XHAKETA E FËMIRISË

Xhaketa me pesë të zotë,<sup>A</sup>  
unë, i pesti, e mbajta veshur<sup>B</sup>  
Sa herë zbriste "një më poshtë"<sup>A</sup>  
merrte një gërshërë nën sqetull.<sup>B</sup>

Me fletë të borzilokëve  
motrat i shtonin lezetin.  
Unë, llastikat e zogjve,  
nuk ia ndava kurrë nga xhepi.

S'iu ankua kujt njëherë  
dhe kur keq i rrinte trupit.  
Hastari që i varej çjerrë  
prindërve ua linte turpin.

Zinte më shtrëngonte supet:  
kohë e ndarjes ! - vetë më thosh !  
Dhe nga unë tek shkëputej  
shihte të vegjlit më poshtë ....

## PISHAT NËN DËBORË

Nuse krejt në të bardhë mbuluar, *A*  
nga udhë e krushqve ✓  
mbajnë sytë pa fund, *B*  
mbi hapsirë secila rri hutuar, *A*  
se s'po sheh dhëndërin gjëkund *B*

**VËLLAI " ME BALLIN",  
PËRCJELL TJETRIN DËSHMOR**

*- dy dajove të mi -*

**Vëllanë në arkivol ... qetë - qetë  
mbante mbi pallton prej shajaku.  
( një shkabë e zezë, mbi krah të vet  
ngarkonte rëndë një pellg gjaku ).**

**Udhët i ndanë në dy botë.  
I gjalli, vëllait të mirë  
gjakun që dje s'ia mbajti dot  
po ia ngarkonte sot të ngrirë.**

**Asnjë postbllok s'i ishte ngritur  
atij që ishte dje "me ballin".  
I vrari po bënte, pa ditur ,  
të njëjtën udhë me të gjallin.**

**S'flisnin. Vazhdonte prapë mëria  
e ndarjes në dy fronte lufte.  
I gjalli prapë nga dashuria  
e mbante tjetrin butë në supe.**

**I madhi nën shajak të zi.  
I vogli - në arkëz arkivoli.  
Secili mbante një mëri,  
po shokut asnjëri s'ia foli.**

**Sa pak peshon, vëlla i shkretë ! -  
i tha i gjalli atij brënda  
që përmbi sup i rrinte lehtë,  
se i kish mbetur vetëm ëndra.**

**Dhe iu lut tokës ku e shpunë  
si me të mirë duke e lëmuar:  
"U vra, se deshi ty më shumë.  
Mbaje në gji edhe për mua !"**

## **NXIN**

**Nxin, kur retë bien shtrëngatë  
dhe qielli mbyllet me fund.  
Nxin dhjetori në një mesnatë  
kur hëna s'duket gjëkund.**

**Nxijnë shpella e gropa të thella,  
buaj e dhën me lëkurë sterrë.  
Nxijnë frikshëm puse - humbella  
poshtë një ujvare - humnerë.**

**Nxijnë rrudhat e thella të gjyshit,  
fundi i kuletës bosh të gruas.  
Nxin thellë te përparsja e lypsit  
copa me të zezë arnuar.**

**Nën përzhitje shkrumbi e baroti  
nxijnë lëndina tërë dhëmbje...  
Po s'e nxin më shumë horizontin  
se shamia e zezë e një nëne.**




## SHQIPJA JONË ME DY KOKË

Flamuri me dy kokë shqiponje, -  
ky fat i ra të ziut Atdhe, -  
mes fqinjëve t' i thonë shoshoqes:  
unë shoh këndeje, ti shih andej.

Pastaj, mbështjellë në dy ngjyra  
tendosur ashpër në furtunë,  
i thonë shoshoqes 'supefryra':  
se ti je "ti", e unë jam "unë" !

Dalë nga një trup si dy binjakë,  
mbi botë bashkë klithin shpallje:  
në u plagostë njëra pakë,  
prandaj është tjetra, të ringjallet !



## **SHQIPTARËT PARA EKZEKUTIMIT**

**Dhe ja, u shuam një nga një,  
ju vramë me rrënjë - tha një xhelat.  
Dikush nga trimat tha nën zë :  
" Mbrëmë të gjithë fjetëm me gratë !"**

*( Mustafa Matohitit )*

Ishe njeri, të kthjem bronz  
siç bëhet me heronjtë mbi dhë.  
Ai bronz sot diku rri nervoz  
Përballë një turme me varrë:

Nëse heroin e prek tek rri,  
bronzi rikthehet prapë njeri.

## **YLBERI " PLURALIST "**

**Nga ultrarozë te violeta  
ylberi i ndezi bashkë mbi fushë  
të gjitha ngjyrat, tërë spektrat,  
ç' ngjyrë të dojë të ndezë gjithkush.**

**Ato rrinë tok në krañë si motra.  
Pa njerën, tjetra vdes mbi dhë.  
Nëse lëndinat janë "shporta",  
ylberi është doreza që i ngre.**

## SALLA E VALLËZIMIT

Ndryshojmë të gjithë drejt dimrit, -  
thinjen njerëz, ujra, drurë ....  
Vetëm salla e vallëzimit,  
ajo vetëm s' plaket kurrë.

Brezat që rininë i falin  
aty njeri tjetrin shtyjnë:  
sa ndjehen të thyer - dalin !  
Sa ndjejnë rininë - hyjnë.

Flokë të zinj e flokë të verdhë  
venë e vinë radhë pas radhe.  
Muzgjet i përcjell nën derë,  
mëngjezit i hap dritaret.

Rregullatorin e shpirtit  
ia mban kënga për të renë.  
Dhimbjen për ata që i ikin  
e mbush me ata që venë.

## PASHË NJË ËNDËR ....

Pashë një ëndër, ç' pashë në ëndër, -  
isha unë e s' isha unë:  
jeta që më vate lumë  
copa - copa më del në ëndër.

Jeta që më vate lumë,  
që më qeshi dhe e qesha,  
vjen më del, dje siç e desha, -  
ç' nuk m' i dha, m' i sjell në gjumë.

Vjen më del, dje siç e desha:  
Zgjat dorën si hije e vdekur -  
pluhur yjesh kap në mjergull,  
siç i këndova në vjersha.

Pluhuri yjor në mjergull  
djersë e ftohtë më rri në ballë.  
Rroj i vdekur tek jam gjallë.  
Jam i gjallë tek kam vdekur.

## 16 MOTIVE KOSOVE

## SKICË KOSOVE

Te ç'ëndër imja ashtu të gjeta !  
Nëpër hutim, ku s'të shetita !  
Kosovë, hyr në një gërmë  
e dil te tjetra,  
si nëpër dhomat e shtëpisë ku linda !

Në buzën tënde gjuha jonë e ngrohtë  
qe drithërimë, ringjallje.  
Dialogun tënd s'di, ç'dramë në botë  
mbi vete e ngarkon reale !

Dielli të lind nga netët pus  
e perëndon flamur i hapur.  
Ikij, dhe emrin tënd e mbaj në buzë  
lule bozhuri të përgjakur.



## **KAÇANIK**

**Ndalëm. Gjithëshka po hesht. Po hesht.  
Çdo gur - një ngjarje, një datë.  
( Ata që ranë, dëgjojnë brënda nesh -  
ç'bëjnë të gjallët lart ! )**

## NË DEÇAN

Çetinave me gjelbërim mbi gur  
era u tund hijshëm drurin.  
Në atë lëkundje, kujtojnë me mall, -  
dikur,  
aty ashtu valoi flamuri !

## **METAFORA E QELISË**

**Trokit pranvera ... trokisnin acaret.  
Ai - në mbretërinë e të ftohtit.  
Në çdo katror me hekura të dritares  
lule - bozhuri  
i mbillte horizontit.**

**Kosova brënda gjumit të pa fjetur  
i rrinte zgjuar, zgjuar pa kufi.  
Gur i çimentos ku rrinte mbështetur  
pa lëndën më të fortë  
te ashti i tij.**

**Sheh qiejt ....  
Te ç'mjergull fshihet nëna !  
Te ç'yll fëmia ngrihet  
edhe bie !  
Ngjyrë Mandele i vishte mbrëmja.  
Mëngjezi i vishte ngjyrë liri.**

## NË FUSHËKOSOVË

Lulebozhurët rrinë kokëvarur  
mbi tokën e të parëve ...  
( i thithin dheut ngjyrimin e gjakut,  
të ushqejnë me të kuq petalet ).

## **DRINI I ZI**

**Me emrin e "Zi" nisesh për Veri.  
Gjelbëron duke ikur, dhe gjithënjë mban zi  
që mbi truallin tënd rrjedh shqiptar,  
dhe s'quhesh Shqipëri !**

## **DRINI I BARDHË**

**Mbi Pejë posa del nër gurë  
dhe diellin sheh mes fletëve,  
lëshohet përmbi zall me vrull  
drejt grykave e shkrepave.**

**I thanë, vëllai - Drini i Zi  
motrën kërkon në bjeshkë...  
Motra në Pejë, sa nxjerr sy,  
vrapon ku mund ta pjekë !**

## TARGA "OH "

Sillesh ngado e përhap ngado  
psherëtimën e shkurtër "Oh " !  
Ç'thotë vallë psherëtimë brënda:  
Si e lashë Nënë,  
a si më la Nëna ? !

## **DIELLA NGA PEJA**

**E brishta çikë kosovare,  
statujëza më e pafaj e botës !  
I preka butë flokët verdhane, -  
preka në tokë diellin e Kosovës.**

**Më shihte si të isha nga planetë të tjerë !  
Brënda atij hutimi, ndjeva  
përmes damarëve që na kanë prerë  
dielli zbret në tokë me emrin "Diella".**

**Mall i një shekulli, tragjiku, njerëzori,  
këmbehej nëpër sytë e njëri tjetrit.  
Më shihte perëndi.  
Ballë saj unë, tokësori,  
mbaja në shpirt dridhjet e universit.**

**Pejë, 1971**



## ABDYL FRASHËRI NË PRIZREN

*- Abdyl, prishe pasurinë,  
një barrë flori ! -*

*( populli )*

**Burrë, o Abdyl Toska,  
bre, mos vdektë kurrë :  
floriri i monedhës -  
flijim nën flamur !**

**Ju shkri tërë floriri,  
s'kishte më ç'të jepte !  
Dhe çdo ditë, martiri,  
zuri shkriu veten !**

**I mbërthyen hekurat ....  
ai klithi prapë :  
Shqipërisë i lashë  
një zinxhir më pak !**

**Dhe këndon lahuta:  
bre, Abdyl me derte !  
Nën hapat e tua  
shtrirë tre kontinente !**

**Poshtë shlodhjes tënde  
me gjumë luani,  
Mic Sokoli ynë  
ka vënë xhamadanin!**

**Prizren 1971**

## **DARDANI DHE VLORA**

**Vëlla e motër nga Gjakova  
dolën më pritën te një portë guri, -  
Dardani e Vlora,  
shtiza dhe flamuri.**

## ERA NË KOSOVË

U nisëm për të ikur.  
Era me butësi veriu  
tek na përcillte në "zakon të mikut"  
në kthesa mbante frymën prej njeriu.

Hapej mbi fushë e ndër kthina  
me drithërima shqetësimi.  
Mbi krahë të saj  
Hasan Prishtina  
verifikonte te çdo fletë blerimin.

Mendonim. Pinim qetë cigar ....  
Era hidhej te varret, vinte veshin  
mos nën qivur  
tek dridhej një fill bar  
një i vrarë pëshpëriste amanetin !

Shpesh humbte larg, thua përgjithmonë !  
I flitnim nga korije e lisa ....  
Ajo pas një lugine thërriste - jehonë :  
"Ku je, Azem Galica ! "

## ELEGJI E NËNËS PËR BIRIN

*(Hisen Kotorrit, martir i përndjekjes  
sërbe. Pas kësaj, nëna i vdiq )*

**Shtrirë me sy drejt lartësive  
në qiell, o bir, ç'po sheh ashtu ? !  
Ç'shqiponjë mban fshehur brënda syve  
që krahë ka qerpikët e tu ? !**

**Te një pikë lot rri strukur bota.  
Mbi ty Kosova hesht e ngrin.  
Në vëndin tim të afrohet Shota  
dhe gjakun me gërshetë ta fshin.**

**Mbi "Lisin" çohet Sefë Kosharja  
me duart mbi litar të vet  
e sheh me madhështi përpara  
se ç'bij të ri Kosova qet.**

**Po ikën. Larg pa ty ç'ta zgjas !  
Meqë s'na lanë të lirë te jeta,  
ty nëna po të ndjek nga pas, -  
po vij ... të rrojmë tok te vdekja.**

## MINATORËT E STARI TËRGUT

Dhe këmbë kryq u ngulën poshtë.  
Dhe toka ndjeu çudinë e rrallë:  
kur hyjnë të tillë nëndhe, o zot,  
të vdekurit qënkun të gjallë !

Dita te gryka e zgafellit  
u shfaqte një zambak të bardhë  
që u dhurohej me mëngjezin,  
edhe në muzg u ikte prapë.

Grua, fëmijë ... i lanë prapa  
sipër mbi tokë. Jetimë nën re.  
Mujit, Halilit thellë baladash  
u shtuan shokë të rinj nën dhe.

**Me zëmërimin e tërë shekujve  
zërin e madh e shpallën hapët:  
flasim nga bota e të vdekurve  
të bindeni, ç'duan të gjallët !**

**Njoftuan vdekjen edhe jetën:  
globit, në shpinë tek e ngrinin,  
i duhet që të ndreqë pa tjetër  
diçka që s'shkon te rrotullimi !**



## DY GISHTAT "V" TË KOSOVARËVE

... Dy gishta në torturë skuqur,  
bozhurë në dhomë "izolimi".  
Dalë nga hekurat e burgut  
i buzëqeshin njerëzimit.

Dy gishta - drejt qiellit sfidë, -  
dy supe lidhur tok përbri,  
me arkivol martiri sipër  
po ecin gjatë në histori.

Grafik i dhimbjes gjer në kockë  
shfaqet kjo "V" si dridhje vale,  
Përmbi antenë të saj, mbi botë  
Kosova kurrë s'i pret sinjalet.

## LOJRAT E JETËS

Vitet 50 ... në Gjirokastrë  
hyra mësues "me të shtyra".  
Rashë mbi bilardo me një stekë të gjatë, -  
u ndiqja rrokullimën  
gurëve tërë ngjyra.

Me një goditje, gurët sipas "fatit "  
hynin në gropa qetë, pa zhurmë...  
( ashtu studentë, ne na shpërndau kuadri, -  
një stekë nga lart ,  
e u futëm ku na shpunë ! )

Me domino shtyra vjeshta me shi.  
Gurët në duar, tërë kujdes mbi to,  
i vija resht, me radhë, me drejtësi,  
thua botën ndreqja saktë në domino.

I kombinoja në radhë të ndershme  
me ortak një marangoz krahine ...  
Po rregulli i ndershëm prishej "lart "  
të nesërmen,  
te kuadr' i komitetit që bënte emërimet ....

## **TE PORADECI**

**... Diku larg te Mal i Thatë, përmbi shkëmb e përmbi gurë  
një shqiponjë e arratisur fluturon, e s' arrin kurrë.**

**Te argjënd i hënës n' ujë derdhur me finesë Venusi,  
fillad i hollë i liqenit lëmon thinjat e Lasgushit.**

**Drini plak e i përgjumur mbushur drithërimë kurbeti,  
nëpër tokën e shqiptarëve rjedh në vargun e Poetit.**

**Rrjedh, e s' i shteroi rrjedha sa të binden rrotull tij,  
sa të bindet botë e shurdhër, se e ka emrin "Shqipëri".**

Te një re e bardhë puplore "qenushi" ka ngritur kokën,  
kërkon në hapsirë të zotin, duke lehur në gjithë botën.

Rosat futin kokën në ujë - ku fle poeti brilant ?! ....  
Në katund troket një portë, në liqen hesht një lopatë.

Nëpër muzg ku duken - çduken krahë të humbur harabeli,  
shtrihen në mistere hijesh "Netët" e Mitrush Kutelit.

Kallamat trazojnë mbi ujra tërë ngjyrimet që jep mbrëmja,  
presin penelin e Mios në mbrëmje të zbresë nga hëna.

Shqiponja e arratisur si e dalë nga një flamur  
fluturon mbi Mal të Thatë, fluturon ... e s' arrin kurrë.

# I NDERSHMI

*( Ndrek Lucës )*

**Në ditën e fundit kur do ndahej me jetën,  
e pashë dhe një herë  
mbi biçikletën e vjetër.**

**Biçikletës, shtrëk - shtrëk, i kërciste skeleti,  
njoftonte njerëzit:  
Po ikën mjeshtri.**

**Dhe udhës, mes njerëzve, ecte ngadalë, e vjetra,  
thua, s' donte ta shpinte te vdekja.**

## MEDITIM

Nga tym i kioskave në parqe  
zogjtë po ikin para stine.  
Të vetmit miq besnikë, vargjet  
më rrinë intimë sipër shpine.

E shkreta pema ime e trurit  
që kokrra lidh çdo stinë që vjen,  
që rri përkulur ballë flamurit  
dhe ujin rrënjës ta kursejnë !

E ndershmja firma ime e varfër  
s'të njohu një liçencë a treg,  
veç letra miqsh e autografë  
që nuk të kthehen dot një drekë.

Me shpirt zgjeruar nga liria,  
me xhepin tkurrur si rrallëkush,  
rri bir pranë trojeve të mia.  
Në vdës në shkurt, rilind në gusht.

## **MANUSHAQJA E NAIMIT**

**Një manushaqe, hapur gjinë në diell  
rri fshehur nën gëmushë të butë ! ....  
Zgjas dorën ... nuk i ngrinte kryet,  
thua pret Naimin ta këputë !**

**Naimin nga muzeu e dëbuan në Sarandë.  
Hasan Prishtina në Kosovë, sa e pa,  
u ul nga piedestali, -  
poetit sovran  
vendin e vet i la.**



## LINDJA E DJALIT TË PARË

I ati e ngriti lart  
të lumtur, të bekuar.  
I biri hapi duart ... babait  
krahët iu dyzuan.

Nëna e hidhte mbi krye.  
Djali zgjaste duart nën fenerin e hënës  
të këpuste një degëz yjesh,  
t'ia dhuronte nënës.

Gjyshes, ajo mbrëmje dimri  
iu bë muaj qershori.  
Në cepin e rrudhave  
dielli i perëndimit  
ngjyrën e lindjes i mori.

Në tërë lagjen dëgjohej  
zëri i thekshëm i foshnjës.  
S'ish vaj ... i vogli akordonte  
zërin e tij  
me zërat e botës.

## BALADA E ESHTRAVE

- (Pas çlirimit, thuhet , me një urdhër nga  
"Iart" eshtrat e Fishtës u hodhën në Drin. )  
- nga shtypi -

U përçafuan tok me Drinin  
posa mbi lumë i hodhën tutje.  
Ujrat me vorbullat që nxinin  
formonin hark djepe lahute.

Muji, sa ndjeu, çau legjendat  
dhe shihte nga një shkëmb qiellor:  
"Ç'baloz i zi a ç'frymë dreqnash  
prekin të Madhin këngëtor ? !

Fishta me sytë nga toka nënë  
brente merakun që s'e ndau, -  
te vëndi bosh që kishte lënë  
mos bënte shteg , e hynte shkjau !

**Mpliksej nër dallgë rreth e rrotull.  
Vraponte, botës t'i gjejë fundin !  
Edhe kërkonte nëpër vorbull -  
ku ishte mbytur Pjetër Budi !**

## MATURANTES ME PELIÇE TIGRI

Tingujt drejt yjve thua iknin  
në atë mbrëmje maturanti.  
Ti me peliçë të jashtme tigri.  
Unë me dok prej kombinati.

Ku isha - s'do ta kuptoj kurrë  
atë vallzim disi magjik:  
Herë në mbrëmje në maturë,  
herë në xhungël në Afrikë !

Ti dridheshe me vështrim gjetkë,  
dhe mua më lije me bishën.  
Gëzofin unë, me dorën lehtë  
ta zbutja, të më linte lirshëm.

Shkujdesshëm fare ti, e lumtur  
buzëqeshje ngado dhuroje,  
gjersa mbi trup, te gjinjt e bukur  
të rrinte ngjitur tigri roje !

Një çast dukej se bënte gjumë  
rreth qafës tënde, sipër gjinjve.  
Sa të afroja pak më shumë,  
zgjohej, më kreshpëronte qimet.

Mbaronte mbrëmja. Veshur "dok"  
kokulur drejt shtëpisë ikja.  
Në ëndra tek qëndronim tok,  
nga xhunglat vinin zëra bishash.

## 12 MOTIVE GJERMANE

## NAPOLEONI NË SINFONINË E BETHOVENIT

E dha në partiturë - hero të gjallë.  
Te vija e kufirit, Perandori  
doli pa Evropën përmbi kalë ...  
"Të dalë prej Sinfonisë ! "-  
klithi kompozitori.

Edhe me gjest të ndritur  
emrin e Perandorit shoi nervoz...  
( mbi partiturë të fshirë u shfaq papritur  
Fusha e Vaterlosë ).

Trumpetat himne i thurnin tiranit.  
Bethovenit shurdhimi iu shfaq më i plotë.  
( Mes vijave të pentagramit  
garda franceze ecte rob ).

Çelësi i notave që niste Sinfoninë  
iu shfaq Ishullë "Elbë " në mes.  
Me fijt e pentagramit që nisën "lavdinë "  
i lidhte duart reshteri anglez.

## KUPA E MBRETIT TË TULËS

Kupa e mbretit të Tulës, akoma  
rri mbytur dhe n'ujrat e brigjeve tona.

Kur valët e nxjerrin mbi ujra të ndritshme,  
hëna nbi det ne na rritet, e rritet ....

Kur valët kupën e zhytin në fund,  
hëna zë hahet e hahet ... dhe humb.

Kur sheh djem besnikë, mbi ujë syrin çel.  
Sa herë ndjen tradhtira, rri zhytur e s'del.



## PEISAZH GJERMAN

Në harmoninë e botës  
gjithëshka në rregullsinë e vet:  
Një shelg sheh Gëten - i përulet tokës.  
Një lis shikon Bethovenin -  
dhe vështron nga retë.

## "DANUBI - BLU"

Valsi fillonte si një ëndërr.  
( të lumturit e vërshëllenin këngë ).  
"Danubi blu" më kërcënonte ëmbël  
nga valët e fustanit tënd.

Ti bëje orbita pëllumbi.  
Unë valsit tënd me zor i bëja ballë:  
herë ndiqja "lumin",  
herë më ndiqte "lumi"  
mbi pllakat e lëmuara në sallë.

Danubi rridhte larg, diku në Evropë,  
madhor, i turbull apo blu.  
Unë kurrë s'e pashë  
as e mendoja dot  
më kërcënues se në sytë e tu !

Një hark fustani si një valë batice  
dilte më prekte. Ngjethesha pa mënd.  
E ftoja pranë ...  
te "shtrati " prapë tërhiqej, -  
i tëri i mbliidhej trupit tënd.

Mes vorbull valësh shokët rreth e rreth  
Valsi shpërndante lumturi të rrallë !  
Danubi ridhte mpleksur midis nesh.  
Ca mbyteshin,  
ca delnin gjallë.

## ZBULIMI I TROJES NGA SCHLIMANI

Të fundit pllakë hoqi mbi Trojë.  
... Nën të, Akili preu dyluftimin.  
Helena buzëqeshur po i zgjaste "mollën "  
mbuluar me hi rrënimi.

Në ILIADË Homeri risheh epilogun.  
Ajaksi i tha -  
a do flarinj, a shpata ? !  
Te çadra e tij e arkeologut  
Agamemnoni shkoi të ndajë dhuratat.

Kali i Trojës barkun la zbuluar.  
Kasandra i hidhte fall për shpresë !  
Gjarpërinjtë Laokontit bijtë ia liruan.  
Priami Andromakën  
ia dorëzoi në besë.

Vdekjet ballë Schlimanit u ngjallën menjëherë.  
Penelopa, zgjuar mes antikuarësh  
me fijet e avlemendit  
që kishte ndërprerë,  
nisi t'i endë një bluzë fitimtarësh.

## "MOLLA " E VILHELM TELIT

Te "mollë "e Shilerit , sa herë  
me jetën time shenjë kam vënë !  
Më dridhej dora si e prerë.  
Por shtiva, sepse duhej shtënë !

Të ruaja bijt, shigjetën lart  
ngrita, e shtiva në erë kot.  
Dyshimi, fyerja zgjatej prapë,  
dhe "mollë" e kuqe nxinte kob.

Te rreth i kuq që quhej "mollë"  
shtëpisë fytyra i rrinte ngrirë.  
O zot, si merrej shenjë aq hollë ?  
S'kish tjetër shenjë në aq hapësirë !

## NË BANKET ME MIQTË GJERMANË

...Diku mënjatë, si nën dritë potirësh,  
Ksilandri e Çabej  
përkulur mbi një pllakë ilirësh,  
harrojnë të afrohen  
në koktejl.

## PROCESION NDERIMI

*( Në varrimin e Konicës, thotë Noli,  
nga fillimi në fund ra vetëm muzikë e  
Vagnerit, më e dashura e tij )*

**Shtrirë, ëndërronte atë vatër shtëpie  
ku me gjuhë ilire nëna të qan.  
Në orkestër telat shkundnin  
ngriticë Shqipërie  
nga muzikanti gjerman.**

**Një zog i largët i vëndlindjes  
iu shfaq në horizonte:  
lypte një vënd mbi tela violine,  
një cicërimë Shqipërie  
sinfonisë t'i shtonte.**

## **ANALOGJI**

**Faust ëndërruesi, Faust ideali !  
Duke jetuar me Mefistofelin  
si na e konvertove  
kontratën me djallin ?  
Si ta kthjem modelin ? !**



## **GJERMANIA NË KOHËRA**

**Në mes Evropës - arrë magjike  
mes dy pëllëmbësh, Francë - Rusi :  
Pëllëmbët mblidheshin e çajne ... titanike  
mbi djep lëvozhgash  
rilind përsëri.**

## **ALTERNATIVË**

**"Proletarë të të gjithë botës, bashkohuni !"-  
na thanë në marksizëm.  
Thamë në letërsi.  
Dhe proletarët u bashkuan -  
emigrantë në Gjermani !**

## **TAKIM NË "SOKAKUN E TË MARRËVE "**

**Në mur një fik. Ne nën të - takimin.  
Diçka përndriti. Diçka u ngërdhesh...  
( Të marrët e Shekspirit e Pushkinit  
pas murit pëshpërisnin vesh më vesh ! ) :**

**Te floku i saj fjongua e gjelbër  
dridhej kur i afroje faqen.  
Për çdo lëvizje pak më tepër,  
zalli nën këmbë qe gati  
të alarmonte lagjen.**

**Mes heshtjes, befas zëra klithën !  
Ajo në krah po mbante vesh hutuese:  
Evgjiti Xhemo  
si kish pirë gjithë ditën,  
ditën e tretë pas dasmës rrihte nusen.**

**Vajza zuri të ndreqë fustanin.  
Dhe ca, të lutem ... edhe ca ! ....  
Një siluetë gruaje pas një xhami  
po i vonohej burrit  
që e priste në oda.**

## **NËNË TEREZA**

**Te ç'dritë një rreze, vallë , të marrim  
t'ia bëjmë portretin të ngrohtë ?  
Tërë qënia e saj  
një grusht ajri  
endur hyjnore nëpër botë.**

**Shami e thjeshtë, shami Tirane  
lëmuar si me frymë zoti !  
Kokës së thinjur i qarkohet anëve  
si një dantellë mjegulle mbi globin.**

**Në sy s'guxojnë ta shohin vdekjet.  
Ecën si frymë.  
Shfaqet si ëndër.  
Të mjerët nëpër kontinente  
ngrenë duart, ta mbajnë si ëngjëll.**

**Vuan - mëngjez ta kthejë dhe një mbrëmje.  
Vëzhgon këputjen te një fill i hollë !**

**Te rrudhat pikëlluese të syve prej nëne  
ndërruan udhë aq arkivolë.**

**Mosha e thellë në pleqëri -  
një luledielli kthyer nga djepi.  
Muzgjet e Nënës Shqipëri  
me krahë mjellme larg e përshëndesin.**

**Mplaket, dhe Atdheut i rri "Gonxhe".  
Zvogëlohet dalëngadalë duke ikur  
sa ledhatushëm, vocrrakët e botës  
në prehër mund ta mbajnë kukull.**

## **NË TREN**

**Nëna e re hapi me ndrojtje gjinë  
t'i jepte qumësht fëmijës së parë.  
Me buzë të tij foshnja mbuloi "bardhësinë"  
siç mbulon hënën  
një zambak reje i bardhë.**

**Njerëzit, me fjalë sikur ta kishin lënë,  
panë nga dritarja, tutje kaltërsie.  
Foshnja pinte i qetë te gjiri i nënës  
si perandor i vetëm  
i asaj bardhësie.**

## LIBRAT E GRISUR NË FUND TË VITIT SHKOLLOR

Në verë, ne nxënës arrakatë,  
me bojë të kuqe a të zezë  
Shekspirin kthenim në "pirat"  
Homerin - me parukë markez.

Shtynim në hartë kufijtë e shteteve:  
Kosovë e Çamëri një shtet.  
Lasgushi - cub prapa një çete.  
Mjeda - me thikë e me beretë !

Në fletë të grisura, të fshira  
mbi kozmos bënim batërdi:  
Humbur pa gjurmë mbretërira.  
Kala dorëzuar pa ushtri ...

Çdo ngjarjeje këputur fundi:  
Duël i Pushkinit as nuk nisi !  
Në fund, Kapitullin e dhunës  
revolucioneve ua prisnim.

## VIZION PALESTINE

Botës heshtjen guxon ia prish  
me sy në yj. Me trup pas hekurave.

Ti - abetare e lirisë.

Ti - enciklopedi e vdekjeve.

Palestinë, gjak borziloku  
që vezullon në yj qershori.

Të nis mëngjezi mbi një krahë zogu,  
të rryllet te një rënie meteori.

Retë zërin e parë të gjëmimit  
e marrin nga vajtimet mbi të vrrarin.

Globit, si bosht për rrotullimin  
tek ti i mjafton dhe një fill bari.



**Njerëzimit po i lodhen himnet  
kur para kimit bota hesht vetiu.  
Mbi vrasjen e një foshnje Palestine  
Krishti përulet, koregjon njeriun.**

**Martirëve jetën epos ua bëre  
kur posi nënës të dhurojnë flijimin.  
Me gjak të tyre, përmbi duna rëre  
fëmijët nisin bukurshkrimin.**

## **DALLANDYSHET**

**Dallandyshet, thonë, venë e vinë  
Mehmet Aliut t'i përsërisin :  
Si nuk e bëre dhe për Shqipërinë  
atë që bëre për Egjiptin ?!**

**Dhe që ahëre u veshën bardhë e zi :  
njera - "Egjipt",  
e tjetra - "Shqipëri".**

## SHTËPIA E POETIT TË BURGOSUR

*- shokut të djalërisë, Pano Taçi -*

Në ngricë të dimrit, në vapën e gushtit  
drrasat e portës krcin - Urdhëroni !  
Te pragu i portës, qeni i Lasgushit  
i flet së largu qenit të Bajronit.

Dritaret hapur - të ngopen nga era.  
Librat lodhur në raft nga pritja e pa fundme.  
Këpucët shtrëmbër lënë te dera  
vështrojnë me bisht syri burgjet.

Në mur ca njolla lagështire  
mbi to si të kesh hequr një portret intim.  
Zëra të largët lamtumire  
mes ëndërrash i tundin shaminë.

Indiferent ndaj dhomës - s'pyet ç'i ka mbetur,  
vetëm t'i mbajë poezinë.

Shtrati disi rrëmuje, i pandrequr  
si strofë pa ritëm e pa rimë.

Shpirti rri jashtë dhe kur ndohdet brënda.

Porta pa çelës tërë njerëzimin pret.

Te nikotinë e gishtave rri hëna

që burg më burg, aq pak e pa në jetë.

Shpesh mbrëmjes vonë, i vetmuar

rreh të pushtojë motivin para se të flejë.

Në abazhur, një llampë e shuar -

një metaforë, që dje s'e lanë ta gjejë.

## TE VARRI I NËNËS

Nga fotografia te varri  
më sheh, dhe s'don të më shohë :  
Ç'do ti, bir, këtu ndër ne !?  
Te buzët e lidhura  
vdekja rri e pa lëvizur.  
Fytyra siç qe e gjallë  
dalë dikur me jetën brënda,  
lidhur me mermer të bardhë  
nënë s'ma lë më të rritet.  
Ti mbetesh nga unë më i vogël,  
më thotë e ikura,  
dhe gëzon, se jam larg vdekjes.  
Në sy më kontrollon nusen,  
si ua kthej në " nënë " fëmijve !

Bëj t'i flas, e nuk flas dot.  
Varri gojën ma ka marrë.  
Të vdekurit pranë saj  
i mban qetë, pa lëvizur,  
mos ndonjë vjen e afrohet.  
Gjymtyrëve poshtë të shtrira  
ua ka marrë lëvizjen bari.  
Vështrimi, nënës nën dhe,  
i del në lulet e bardha  
që te koka i kanë mbirë.

Bletët me mëndje te mjalti  
mërmërijnë lule më lule  
ninullat që më ka thënë.  
Hesht, e birët s'i ankohet  
që e lamë, në varr të çlodhej.  
Te një re mbi të, rri varur  
shamia që dot s'ia bleva.

**13 MOTIVE HELENE**

S

## **FQINJIT TIM GREK**

**Me trungje të mi pelazgë, ngrite  
zjarrin madhor të kulturës helene.  
I përulem hyjnisht asaj flake magjike.  
I për buz përmbi to  
tymrat shovene.**



## QILIMI I PENELOPËS

T'u kthye burri, të qeshi vëndi  
iu ktheve atij e tëra përsëri.  
( Më në fund e le avlëmendin  
lodhur nga loja e tij ).

Duart të ranë në heshtje.  
Nën to, gishtat e tërë grave në botë  
vazhdojnë e vazhdojnë endjen...  
sa t'u kthehen të gjithave  
të ikurit bashkëshortë.

## **SOKRATI**

**Bostanin e madh të kokës sate  
me farat e pjekura gati në të rënë,  
rrugëve të Athinës leksion e mbartje  
gjer te buza e burgut të rëndë.**

**Helmin s'do ta pije aq prerë, kokëgdhë  
po ta dije, se në kohët që vinë  
fajtorët që s'duhej të rronin më,  
s'do guxonin vetë ta pinë !**

## **MOLLA E AFËRDITËS**

**Në një orë letërsie së pari m'u shfaqe  
molla magjike, dashuri hutim,  
veshur me purpur faqesh të vajzave,  
me të kuq gjaku në dyluftim.**

**Nxënës gjimnazi, naiv si të tërë  
brënda "Iliadës" u zgjata t'i marr erë.  
E mora. Sadoqë ia dhashë vetëm njerës,  
të nesërmen plasi që plasi sherr.**

**Zhurmuar tre sokakë Gjirokastrë.  
Për mbrojtje s'kisha asnjë armë në brez.  
Fajtor, lashë "mollën" sipër një sofate,  
dashurinë lashë në mes.**

**Molla - dajre e kuqe dasmash  
gjëmoi në martesën e gjitonit evgjit.  
Sytë më rrinin me purpur vajzash,  
... e paarritëshmja Afërditë !**

## THUNDRA E AKILIT

Shigjetën në thundër ta pashë që fëmi,  
te një Antologji në gjimnaz.  
Nuk e dija, se s'qe veç tek ti !  
S'e dija, se të gjithëve  
ajo na ndjek pas !

Ma kërkuan atë "thundër" si çdo viktime  
jo te këmba konkrete,  
po në gjithë qënien time,  
në biografinë e shumë jetëve !

Thanë - ia gjetëm ! - dhe shtinë të gëzuar  
nga tribuna mbledhjesh së pari...  
Në vënd të shigjetës  
te "thundër" e qëlluar  
dridhej e ngulur një firmë funksionari.

## DJEPI I HOMERIT

Në Azinë e Vogël, pesë Qytete - Shtet  
dikur për ty u grinë në sherr -  
kush vallë të kishte bir të vet !  
I kujt qe djepi yt - Homer !

Në syt e tu  
Troja s'i shuante urët.  
Në zgavra mjergullat - krijuan mbretëri.  
Botës duke i numëruar qivurët,  
"vështrimi" yt humbi djepin e tij.

## **PËRBALLË PËRGJIGJES**

**Nderoj Akropolin lart.  
Nën të janë dhe eshtrat e të parëve të mi.  
Nderomë ata që për ty ranë fli  
dhe flenë heshtjen e gjatë !**

## PËRKTHYESI

- *mikut tim Pano Çuka* -

**Njerën gjuhë e këmben me tjetrën  
( si vizitën e mikut te një mik ), -  
krahë të njëjtë, fluturime të ndryshme,  
dy zogjtë e shtëpisë  
nën qiellin ballkanik.**

**Fjala sa përkthehet hap dhomat pa merak :  
Bujrum ! - symësy çdo kënd shtëpie.  
Një gjellë më shumë, një lugë më pak -  
konakë të ngjashëm gjitonia.**

**Një gotë dhallë nga dy avllitë.  
Kalamajtë e dy anëve në lojë merren vesh.  
"Mitera" dhe "nëna" marrin hua shamitë.  
Kutitë me duhan ndërrojnë pleqtë në shesh.**

Miauli të pret me një valle arbërori.  
Mermer i Akropolit - me dritë Arbërije.  
Marko Boçari të dhuron "Fjalorin".  
( Andartët fshehin thikat në hije ).

Oaze pelazge te njëri e tjetri.  
Nëpër fjalë - nga një çikëz "zot".  
Një blu qielli, një blu deti  
lidhur në një horizont.



## REFREN PËR KALIN E TROJËS

Ka kthyer udhë. Që nga Troja  
sulmon gjitonin në veri.  
S'rri më mister, i erdhi goja  
sot këmbëkryq në Shqipëri.

U riprodhua midis nesh  
dhe jep bushtrina skaj më skaj.  
Tinzar, me sytë gjer në Lezhë  
rrinë në "bark" si të pafaj !

Kalin nuk e shqetëson më tmerri  
se brënda s'ka helmata e shtiza,  
po thasë patatesh e sheqeri,  
blloqe dhrahmish e fletë vizash !

Cinik, më i pabesë i dheut  
barku i tij mban skedat radhë  
me ftesë dhelpre të Odiseut  
për deputetë e gazetarë ...

## **KU - KU ÇAMËRI !**

**Zogu i legendës, ku - ku ... ku - ku ....  
nga prrallat shqiptare, nga mitet greke  
vajton atje, këlthet këtu  
me ulërimën e shekujve.**

**Si fqinj fisnik të dhashë gjak për lirinë.  
Po ti, ç'qe kjo gjëmë që më dhe ?  
Të bukurën e Dheut Çamërinë,  
ma le pa folë !**

**Zogu Gjon nga mitet i zgjuar  
me sqep shkul pendët me klithmë revolte:  
"Merrini, në s'keni për të shkruar për mua,  
Çamërinë thesprote!"**

**Ku - ku ... ku e ka strehën historia  
për këtë tragjedi të re:  
E bukura e Dheut, Çamëria,  
pa folë !**

## **FTOI I FËMIJËRISË TE DERA**

**Një degëz e brishtë ftoi  
më zgjatej gjer në dritore.  
Sa vinte vangjelizmoi  
veja, vija një verore.**

**Qielli e ftonte përpjetë,  
që të zgjatej sa më shumë ....  
Ai shtrëmbëronte degët,  
mbi to lart të hipja unë.**

**Përmbi degëzën plot vesë  
mbushur lule xhevahiri,  
rrinte rëndë një këndez  
si me uniformë veziri.**

**Mjegullat që vishnin fushat  
ndjenin luftë e ndillnin tym ....  
Gratë me mëndjet te luftrat  
bënin djem me kokat gjym.**

Jeta mos të na këputej  
ftoi desh kurban te rrënja.  
Këndezit në lafshë i skuqte  
gjaku, kur e theri nëna .

Gjyshja, te ftoi kur hapte,  
njihte si do vinte vera.  
Pastaj shihte, ç'meit ngjante  
te kokrrat e tij të verdha !

Dimrit, nën borë përkulej.  
Në mars, sa vinin veroret  
nga malli për dimrin, lulet  
i bënte si fjolla bore.

## **QENI YNË BALO**

**Hynte viti i 40 - të.  
Në kasolle te tërshëra  
Balos, qenit tim të shkretë,  
befas iu ndryshuan zërat.**

**Sa i jepnin hirrë të pijë,  
zgjaste qafën e këputur  
dhe ksinjej posi fëmijë  
që kërkon nënën e humbur.**

**Nëna s'lodhej, duke e thirrur  
butë - butë si shënjtore.  
Zëri i Balos lodhur, ngjirur  
dilte çjerrë si nga thertoret.**

**Sillej angullinte prerë  
me rënkime thellë nga shpirti,  
i lihte hënës së verdhë  
që i ngjante kokë meiti.**

**Një mbrëmje, mbi kashtë të lagur  
gjitoni e vrau pas porte.  
Balos sytë i mbetën hapur  
që të shihte pas, ç'do ndodhte !**

**... Zërat në fund të ndryshuar,  
i rridhnin currilë te gjaku.  
Lufta që sa kish filluar  
i qasej fshatit te praku.**

## **PARKU NATËN**

**Një mall si prej ëndrre ndihet nëpër erë.  
Hëna degë më degë shket si mace e verdhë.**

**Gjethja del nga heshtja, dhe bie në heshtje,  
mos dëgjon në stola një fragment bisede !**

**Fryn, e fletët degëve pëshpërijnë nën hënë  
fjalët gjysma gjysma që çiftet kanë lënë.**

**Pastaj tundin kokën- ( lidhin fjalë të tëra ) -  
për ç'panë, dëshmitare të mos dalë asnjëra.**

## ZOGJTË

Zogjtë në qiell venë e vinë, -  
s'di nga vinë e s'di ku venë !  
Shkoi një jetë, ata s'u lodhën,  
lidhin qiellin me dhenë.

Vinë nga fëmiria imë,  
venë te fëmiri e tjetrit.  
Imazhit të arkivolit  
i çojnë mallin e djepit.

S'kanë frikë nga gërxhet sipër.  
Nuk hutohen poshtë nga honet.  
Me krahun e hollë, qiellit  
i zgjerojnë dimensionet.

Kur humbin, ku vatë? - i pyes  
me sytë lodhur nga koha.  
Ata shkojnë të zbulojnë  
hapsirat që dot s'i njoha.



Një mbrëmje pa pritur kthehen  
si të lodhur, si të lumtur  
me vesë të pa njohur krahëve,  
në sqep - me një yll të bukur.

Dhe më ulen miqësore  
te mimoza pranë pallatit.  
Kur fle, në ëndër më lypin  
njerën nga foletë e fshatit.

## RRAPI I ISMAILIT

*-Në Mesaplik të Vlorës është ende  
Rrapi, nën të cilin I.Qemali kuvendoi  
me fshatarët më 1908 -*

Bisedës Rrapi veshin i kish vënë -  
ç'thosh Ismail Qemali  
me lebërit karshi !  
Dhe kurrë më i moçëm s'kish qënë.  
S'kish qënë kurrë më i ri !

Zogjtë kishin prerë çdo cicërimë kënge  
Që Ismail Qemalin të dëgjonin.  
Gjethet mbi krye - duar nëne  
që uleshin,  
thinjat t'i ledhatonin.

Kuvend të tillë me sy për luftë,  
kish vite, Rrapi nuk kish parë.  
Mornicat e gëzimit  
që ndjente në trup  
i gudulisnin sythe për lastarë.

Zëri i tij - madhor në histori -  
lidhte qiell e dhe së toku.  
Degëve të Rrapit  
çdo buzëqeshje e tij  
i ndillte dhe një fole zogu.

Lebërit mbështetnin mjekrat te dyfekët  
Ai, një perëndi mbi pllakë guri !  
Rrapi drejt tij zgjatëte degët  
t'ia jepte shtizë flamuri.

Dhe rri tund degët nër stuhira.  
Kur befasi e merr malli  
pyet re e zogj mbi hapësira:  
"Ku është Ismail Qemali ! "

## **NË MES**

**Ndodh shpesh, kam zënë lundroj mes jush,  
kUNETËRIT e mi të gjorë :  
Një terr "i zi ", një gjak "i kuq ".  
Një sot në burg. Një dje - dëshmor !**

**Ngjitur si dy kapakë tok,  
më lidhni dosjen - "biografi ".  
Një më pengoi të shkoj në Moskë.  
Një për Tiranë më dha "dëshmi ".**

**Një hapte portë. Një mbyllte derë  
në udhën time tërë kujdes.  
Një këmbë në dritë. Tjetra në serë,  
pa asnjë muzg pajtues në mes.**

**Një hapte burg. Një e mbyllte prapë  
tek dilte befas "garanci".  
Një faqe më kuqonte gjak.  
Tjetra më rrinte në "të zi".**

**Herë një në fund. Herë një në ballë  
kapakë te "dosja" lidhur fort.  
Njeri i vdekur, tjetri gjallë  
mes tyre s'bëjnë gjyq më dot.**

## TRUNGU I PËRZHITUR

Ende i njomë i ra rrufeja  
se ëndërroi pak qiell të bukur.  
Dritaret me vështrim nga reja  
iu bënë me katrorë burgu.

Fidanët tanë disi fatlumë  
që gjithsesi u lanë pa prekur,  
përulin kryet në atë shkumb  
ku nxijnë tragjikë lastarë të djegur.

Te ajo blozë e zyrtë druri  
sot shohin veten biografitë.  
Kush vallë mund të ngrerë flamurin  
përmbi thëngjijtë ku nxijnë qelitë ?!

## LETËR ARBEN BROÇIT

Vë synë te plagë e trupit tënd -  
ti s'e ndjen më, mua më dhëmb.

Tyta e armës - viaska krejt.  
( mes tyre vrasësi dridhet, shket .... )

Te ç'kasafortë, te ç'dosje vallë  
i fshihet emri - inicial ?!

Partitë po grinden gjatë në sherr.  
Ty vrasja po të rri mister.

Me sy te brima jote - plagë  
sheh komedinë e gjyqit lart !

Tek unë fle plagë e trupit tënd.  
Ti s'e ndjen më. Mua më dhëmb.

## FËMIJA BRËNDA SHTATZANËS

Më të dalë të lagjes sime  
çdo mëngjez më del përpara  
një grua e re, shtatzënë  
që për ditë i rritet barra.

Foshnja brënda s'di ç'ndodh jashtë,  
kush ka faj, kush transparencë !  
Gjaku i nënës, për vete  
i mjafton për asistencë.

Duart futur brënda vetes  
të brishta si qelibar,  
s'ia zgjat dot asnjë partie  
t'i marrë tesër për antar.



**Me veshin te dejt e nënës,  
një zë larg diku i flet ....  
S'sheh dot asnjë vënd për kioskë,  
s'dallon dot kush do rryshfet !**

**Qëndron përgjumur, asnjanës,  
sikur vetvetes i thotë:  
Mos bota do parë symbyllur  
që mos shohë kaq demagogë !**

## GRUAS

Ledhaton vajzën, përkëdhel birin ....  
Të afrohem. Ti mendon pazarin !  
Te thinjat rri të lëmoj hirin  
dhe më merr mall për zjarrin.

## **KUR KËNDOJ ARBËRESHI**

*(Zef Kakocës)*

**Erdhi dhe këndoi ngrohtë te nëna.  
Nëna birin me mall rri dëgjon.  
Qengji i Rinës blegërin nga hëna  
thua hëna iu duk mikrofon !**

**Që nga historia vinë imazh  
kuaj lufte e bardhina deleje.  
Milosao lodrat la një çast  
dhe tundte këmborët e kangjeleve.**

**Këngëtari brënda mikrofonit  
lëmonte një zog që mbante vesh.  
Përmbi skenë, te llampat e neonit  
ndrinte hënë e fshatit arbëresh.**

**Duartrokitjet hapen valë - valë, -  
shekujt kuqezi trazojnë zërat.  
Kombi, i bashkuar në një sallë,  
foli shumë ... dhe s'i tha të tëra.**

## SHQIPTARI I BREGUT

*( Mikut të dashur Andrea Varfi )*

Erdhi fidan e iku lis shqiptar.  
Shkëmb labërie me ngjyrë limoni.  
Toka donte në gji dhe një njeri - thesar,  
i hapi vënd ... e mori.

Det i vëndlindjes shfryn pikëllimin:  
ku shkoi ynë - bir ? S'e bëmë kështu me fjalë !  
Një zog mbi valë dekretoi vendimin :  
shkoi, të vdekurve  
t'u shtojë dhe një të gjallë !

Tani pajtuar me heshtjen - paqë,  
i gjallë si në dremitje,  
në tokë mban vesh, e dëgjon sakaq :  
të gjallët amanetin  
si ua mbajnë të ikurve !

## **KËPUCËT E MIA TË GRISURA**

**Nën ca dërrasa te ballkoni  
një strehëz keni gjetur.  
Me majë nga unë, gojëhapur medizioni,  
thua diçka pa thënë ju ka mbetur !**

**S'di, më qortoni a lëvdoni  
që dot s'ju lidha me pritje të shtune,  
që nuk ju ngjita në një shkallë avioni,  
që kurrë s'ju kapardisa presidiumeve !**

**Të shtrënjta, e mbani mënd pa tjetër  
kur dilja udhës nga mbledhjet dënuar,  
jua shkurtoja edhe juve jetën  
duke u rënë gurëve me majën tuaj !**

Revoltë s'bëtë kurrë vetiu  
dhe kur e shqepura kish nisur.  
Nga vënd i çarë më fusnit ujë shiu,  
të më kujtonit se qetë grisur.

Nëntë vjet punëtor, ju lashë pa "zyrë".  
Ju mbyta llucë ... ju heshtnit pa gojë.  
Protesta më e madhe -  
rrudhnit lart fytyrën,  
kur pranë llustruesve nuk kisha për një bojë !

Si bir fshatari, në fshat herë pas here  
ju çoja, thua atje rrrinit më qetë.  
Në majë te e çara  
mirrnit një luleshqerre,  
e sillnit në qytet.

Ndoshta, një shpresë prapë ju mban,  
sado të vjetëruara gjatë:  
në u bëfshin ca më keq këto që kam,  
mos kthehem ju marr prapë !

## MOTIVE GRI

## **GURËT E PIRAMIDËS**

**Gurët në majë të piramidës  
qëndronin, se i mbanin të poshtmit themel !  
( servilët poshtë  
mbanin tiranët sipër,  
se puqeshin te vija - prerë në një model )**



## **NË PARLAMENT**

**Fjalorë debatesh qesharakë,  
si drurë tërë lagështi e brymë  
që s'kanë fuqi të bëjnë flakë,  
dhe nxjerrin tym.**

## DEPUTETI MUMJE

Ç'dramë ka kombi - gjë s'nuhat,  
veç "dakord!" votën besnike.  
Dora dru - gjithmonë lart  
i shton dhe një këmbë karrikes.

## HIPOKRITI

**Ndërroi fjalorin tok me klimën.  
Në stinë të re, drutë i pret ndryshe:  
dje tundëte shtogun, sot dafinën,  
nga zog grabitës -  
"dallëndyshe"!**

**Karrikes jetën t'ia zgjatë  
xhaketës i do ndrruar qafa!  
Dhe xhep "i majtë" fryrë nga paratë  
iu shfaq papritur tek "e djathta"!**

## VARIANT KARRIERISTI

**Me gruan e shefit lidhi miqësi,  
të bënte karrierë lart ministrive...  
( I ra në mënd, në fëmiri  
lisit i hiqej  
me anë të hardhive ! )**

## ANALOGJI

**Në sy s'të flet për asgjë.  
Pas krahësh, përshpërit gjithë botën ...  
( Burma, dredhur pa zë,  
hyn saktë e më thellë se gozhdët ).**

## **KTHESA TALENTI**

**Iku nga redaksia,  
s'e mburri më kritika!  
S'u pa, kush qe talenti,  
ai, apo karrikja ?!**

## KRITIKUT QË TË MBYT LËVDATA

**O mik kritik,  
ç'ia vesh me kaq lëvdata  
dhe ballin njerëzor që i bëri nëna?!  
Dasma nuk matet me gazet përjashta,  
po dhe me ç'ka trapezi brënda !**

## HIJA E SPIUNIT

I jep dorën miqësore,-  
llumi i fshihet te parfumi.  
Gishtat - materie njerëzore.  
Unaza - lëndë spiuni.

I sheh dy harqet e buzëve -  
s'ua kupton rolet dyzim:  
një ngarkuar plot me puthje.  
Tjetra ngarkuar rrëfim!

Vjen mik, shkrihesh si ta presësh  
pa ditur pse vjen më shumë:  
darka ta jep burrë të besës,  
mëngjesi ta gdhin spiun.



**Çdo gjë dyzim hap për hap  
mynxyra shfaqet fatlume:  
Sa hidhet këmba e djathë,  
e majta shkon pas spiune.**

**Ndahesh me puthje e çmallje...  
Pastaj kujton se ç'fjalose:  
cila nga fjalët e fjalëve  
të nesërmen shkon në "dosje"?!  
?**

## ZOGU

Për nën ballkon m'u ndal një zog.  
S'i fola as "shok". S'i thashë as "zot".

Më pa një çast si me hutim  
pastaj ia dha në fluturim.

Te krahët në erë s'i pashë dot  
as gishtat "V", as grushtin "bllok".

Ikte, e thirrte në kaltërsi  
"ciu-ci-ci..."  
Demokraci!

## EMIGRANTJA

( poemë )

- vajzës -

U linde, tek më prisje jetë të "artë"  
e mira bijë, e pa zëvendësuar !  
Po bota siç më gjeti, prapë më la të varfër.  
Dhe ti shkel dheun e huaj  
me këpucë hua.

"Kombi" shtëpinë babait thatë ja la.  
Gëzimi i saj - brënda një gote çaji.  
Dhe qielli koregjon çfarë toka nuk të dha:  
Me avion çan retë  
mes zotit e babait.

Po na afrohet dimri - brisk.  
Bisedës në shtëpi i shtohet terr i heshtjes.  
Gazit të çiltër të shtëpisë  
çelësin e hënës  
ia more me vete.

Era e vjeshtës si para shtërngate  
pemëve u vjen me kërcënime gri.  
Merr e shtyn gjethet - turma refugjate  
pa u dhënë një "vizë",  
pa një "garanci".

Mbi hotel "Dajti" muzg i murmë.  
Trotuarët siç e gdhijnë, e ngrysin.  
Një moshatarja jote  
mbytur në parfumë  
i del të huajit përpara lypësit.

Me xhepat fryrë nga fitimi  
sheshi te Banka zien xhambazë.  
Rrethit të hënës  
mbrëmë buzë perëndimit  
me sy ti i prisje hollë një unazë.

Vite e vite, thua brez pas brezi  
me mjegullinë të rëndë në sy  
nëna e priti yllin e mëngjezit  
te radhë e qumështit për ty.

Ngarkuar me natën e pa fjetur  
burrat, si sillen rrethe qark,  
me shtypin e "opozitave" nën sqetull  
u çojnë shtëpive  
një "kile" më pak.

Në tavolinë të pseudodemokratëve  
ku njerëzit shpejt e ndërruan "këngën"  
shalqini i fryrë i privatëve  
ndjen turp, që e ka të kuqe zëmrën.

Parti me bursa pelegrini  
shëtisin, mënjanuar nga flamuri.  
Me fijet e fjalimeve që grindemi  
Athina e Beogradi  
na thurin qivurin.

Yt atë, një jetë të tërë mjerimesh  
Evropës kurrë vizitor s'i vate.  
Ta dorëzoj i thinjur, bija ime,  
shihe edhe për mua refugjate.

Orizi i dasmës që vellos ia hoqe  
i shtohet nënës dhe një drekë racioni.  
O Shqipëri, ç'u bëre zotave -  
më "i shenjti" dhe i kombit,  
aerodromi !

Shkëmbehemi në sytë e butë,  
ti - njeri ajri. Unë - njeri toke.  
Me lotin tënd, më ra në sup  
një metaforë që më mundonte.

Librat e letërsisë, të qeta  
të mbetën hapur radhë te dhoma.  
"Herojtë" të fyer  
dolën nga vetvetja  
dhe morën udhët tona:

Sançua u zgjodh agjent i Karitasit  
pakot me ndima për të ndarë.  
Zhulieta me blu zhins përpara "Dajtit"  
sheh, cili nga turistët  
ka më shumë dollarë.

**Para gjykimit Ana Karenina  
me një hetues bën pazar te Lana.  
Peshkopi Sebastian nga ajodhima  
i shkruan Heminguejt :  
"Për mua bien kambanat !"**

**Për një parti të re, Jagua me listë  
grave për firma u qepet pas.  
Homeri në pavion  
grindet me okulistë  
se farmacitë s'kanë ilaç !**

**Në vënd të kafkës, Hamleti pazareve  
provon me gishta një shalqi.  
Plaku Grande  
pranë Lidhjes së Shkrimtarëve  
ka ngritur një rostiçeri.**

**Te cepi i Bankës Çajlld Haroldi në ikje  
po ndërron dhrahmi për Jug.  
Me refugjatë Lasgushi  
bën punë politike  
te derë e ambasadave në rrugë.**

**Avjoni dem i egër,  
në ngritje shtoi një gulçimë bishe:  
pranë krahëve  
kërcënoi një degëz  
që i lutet e përlur, të mos niseshe !**

**Kronisti i huaj, bjond shtatlartë  
ngjit shkallët me hapa të lumtura:  
Në aparat ka Atdheun tënd sakat  
të shkatërruar  
si nga njëzetë luftra.**

**Era mbi avion si dorë e butë njeriu  
lëmon të zbutë duraluminin.  
Niset nga jugu,  
kthehet nga veriu  
si me dy mëndje udhetimi.**

**Ja u shkëput, e vate !  
M'u tkurr. M'u drodh Atdheu.  
Nën këmbë të sime bije refugjate  
mori të çarë  
legjenda e Anteut.**



**Një reze dielli - flori i tërë  
thyer te xhami, mbi fustan të kapet.  
Sillesh, si ta këpusësh për gjilpërë  
nga larg babait  
t'i arnosh çorapet !**

**Diku nga sipër përshëndet me dorë  
shokët pa punë, trotuareve ku rrinë.  
Së largu u varesh meteor  
që bie ndritshëm  
e s'arrin.**

**Qielli e det, dy kaltërsi të thella,  
t'i mbushin sytë mirazhe brilante.  
dëti në breg me shkumë thur dantella  
dhe prapë i prish  
se vajzat ikin refugjate.**

**Po zgjas vështrimin gjer nga hëna  
duke të ndjekur në të çdukur.  
Avion i vogël me ty brënda  
në qiell larg  
u kthye kukull.**

Shpejton, gati po ndjek me anth  
diçka hapësirave të zbrazëta.  
Një copëz re e bardhë të ngjitet pas  
si vello nusërie  
që e le prapa.

Një vetëtimë pas xhami të ndjek në ikje.  
Te ajo dritë e thyer t'u zgjat  
thika e frikëshme e banditëve  
që mes Tiranës  
të prënë udhë më "Fiat".

Avioni varur si te hëna  
i lehtë, i lehtë, lodër ajri,  
si rjeta e ushqimit që në dorë mban nëna  
kur kthehet nga pazari.

Deti tërë drita bluje ...  
mirazhe refugjatësh mbart mbi vete.  
Floriri  
i hënës sipër ujrave -  
flokë rinije  
që kaptojnë dete.

**Arbëresheve me foshnje në sisë  
u theri gjiri si nga një mandatë.  
De Rada mbi një shkëmb të Kalabrisë  
sheh refugjatët  
dhe riplaket prapë.**

**Gërmadha shkollash në përzhitje  
Nga poshtë, xhama thyer skandalesh  
ish nxënëses në ikje  
drita të prera  
i çojnë sinjale.**

**Me gurët shkrumb të Shqipërisë gërmadhë  
që e veshin vëndin tmerre,  
dikush fsheh krimet 50 vjet me radhë,  
Dikush me to  
ndërton podiumë kariere.**

**Kalit të Trojës hapur derën,  
i lihen troje me turpe dekreti.  
Demokraci me kombin prerë -  
lule  
në trupin e të vdekurit.**

—  
Intelektualët atdhetarë  
në udhë befaps sprapsen  
Përballë tyre, si të marrë,  
kalojnë komodë  
bensat e kasapëve.

E kemi në mes nesh njerinë -  
dje politikën, e sot tregun.  
Ti klith - Kosovë ... te "K" - ja ai kap kredinë.  
Ti qan për Çamëri,  
te "Ç" - ja ai kërkon çekun !

Atdheu poshtë Evropës, një pëllëmbë,  
siç e krasitën, siç e korrën !  
Të shkretit shtetit - amë  
i mirren këmbët  
tek matet që të mbajë në shpinë Kosovën

Një ulërimë e largët nën qiell çeliku  
zgjatet më tej nën erëra tragjike :  
era ngarkuar vaj, e Kaçanikut,  
ndjek refugjatët,  
diç t' u thotë në ikje.

**Në jug po merr të çarë Atdheu.  
Naimi në Sarandë mbi një gur vetmie  
flakur nga tokë e tij,  
përzënë nga muzeu,  
qan delet që i ikin Shqipërie !**

**Ulesh. Berlina - vizione së largu :  
Me djersë mbi thinja,  
me ballë perëndie,  
Abdyli, posa doli nga Bismarku  
të nguli sytë - a je ilire ? !**

## DHOMA E GJUMIT

Sa pranë ndënjëm të dy, sa pranë  
brënda kësaj dhome  
si tej tjetër bote !

Një hekur në mëngjez përmbi çarçaf të bardhë  
dhe prapë, e bardhë paq, dilje nër shoqe.

Nga kjo hapsirë shtëpie, gjithësesi  
botës ju shtuan ca dimensione.  
Gjithëshka e gjallë  
që endet në shtëpi  
borxhli i mbetet kësaj dhome.

Përballë, pasqyra shikonte diskrete  
edhe siç qemë na fuste brënda qelqit.  
Të nesërmen e ftohtë, indiferente  
ç' shihte nuk ja tha kurrë tjetrit.

Këtu aq halle hodhëm ne pas qafe.  
Si rrobë të tepërt  
shtymë vitet boshe.  
Dhe orenditë vjetërohen, mplaken  
rrethuar qetësi e paqë prej moshe.

## **TE ULLINJTË E VLORËS**

**Sa larg është ajo kohë, sa tutje  
kur ndenjëm tok tek ky ulli !  
Tërë ajri binte erë puthje  
dhe unë bija erë "ti" !**

**Me emrin tënd m'u stolis bota,  
dhe ne u ndamë kur dimrat hynin.  
Me sytë e tu ullinjtë nxinë kokrrat  
me mallin tim fletët po frynin.**

## **NJERIU**

*- Mikut të djalërisë, Bekim Harxhi -*

**Njeriun e mirë, njeriun e rrallë  
e kërkove te të rinjtë,  
e kërkove te të vjetrit ....  
Meqë s'e gjete në të gjallë,  
shkove ta gjesh në të vdekurit.**

**Na u ndave herët, shkove fjete.  
Te vendi yt bosh  
pranë më le vdekjen.**



## VDEKJA

Ditë për ditë, pranë e më pranë  
del e më kujton - "je imi !  
Vur faqen tek unë, e shlodhu !"  
S'i përgjigjem. I largohem.  
Nëpër avuj të kafeve,  
nëpër rruaza rakije  
humbet shënjë e ikën prapë.  
Më gënjen mëndja se ikën !  
Tek rri vetëm ... shfaqet prapë  
butë - butë si një gjumë  
që s'e dua dhe e dua.  
Mëndja s'ka fuqi t'i ikij.

E ndjej, më shfaqet nër këmbë  
tek i ngjit shkallët i lodhur.  
Më del si hije e bardhë  
te thinjat rënë në supe.  
Më hyn në xhepet pa lekë  
dhe pret, sa ta prek me dorë  
diku fundit të hastarit.  
Pas një psherëtimë dhimbjesh  
kur shoku del i pabesë,  
më nder supin, thotë "mbështetu !"  
Rri mes meje edhe gruas  
në kufijt e lodhura  
kur na janë mbaruar fjalët.  
Shtrihet mbi titujt e librave  
që presin sponsor botimi.

**Troket tek më vret këpuca.  
Më flet shkoqur brënda kollës.  
Thërret nga varri i prindërve  
që s'e kanë siç ua desha.  
Ulem mbi punët e mia.  
Ajo del më flet nga rrudhat.  
S'më thotë emër. S'më nxjerr pamje.  
Thua është bërë prej ajri  
ku shpirti do më përzjehet.**

Ç'u largua kaq shumë, kaq shumë  
dhe kaq pranë vjen e më rri  
ajo kohë kur ishim të rinj !  
E tani s'i kap dot asnjë gjurmë  
asaj kohe, larguar aq shumë !

Dhe ti ishe ëngjëll, i brishtë,  
feksur sytë me përndritje ari.  
Ku ta dije ti, se një ditë  
tek më dridhje flokët në gisht  
do të varje trasta pazari !

Horizonti m'u duk pallat - qelq  
ku ne bashkë do rronim si zogj.  
Ç'na gënjeu jeta kaq keq,  
na jep mënd sot që bëhemi pleq  
ne, hënorëve me ëndërra për zogj !

Kur më erdhe ti, dashuri,

unë isha i verbër krejt.  
Kur më ikje, thashë s'ikje për jetë !  
Sot dyshoj, isha unë ai i ri  
kur më erdhe ti, dashuri ?!

Duke pritur atë që s'e pres,  
sodis hënën të ngrënë nga poshtë.  
Gruaja hyn me trastën bosh.  
Më vështron ... e vështroj edhe vdes  
duke pritur atë që s'e pres.

Ç'presim më, e dashur, të ikim !  
Na e vranë kaq ngrica shpirtin.  
Veç të lûtem, për ç'të kam dhënë,  
ule pak atë hënë të ngrënë  
që ta bëj arkivol, dhe të ikim !

# PASQYRA E LENDES

Fryma e shtëpisë në fshat .....	3
Udhët në pllajë të malit .....	6
E vjetra urë e fëmijërisë .....	8
Libri i parë në vitrinë .....	10
Xhaketa e fëmijërisë .....	12
Pishat nën dëborë .....	13
Vëllai me "Ballin" përcjell tjetrin dëshmor .....	15
Nxin .....	16
Shqiptonja jonë me dy kokë .....	17
Shqiptarët para ekzekutimit .....	18
"Ishe njeri, të kthyer bronx" .....	19
Ylberi "pluralist" .....	20
Salla e vullzimit .....	21
Pashë një ëndërr .....	22
<b>15 motive Kosove:</b> .....	23
Skicë Kosove .....	24
Kaçanik .....	25
Në Deçan .....	26
Metafora e qelisë .....	27
Në Fushë-Kosovë .....	28
Drini i Zi .....	29
Drini i Bardhë .....	30
Targa "OH" .....	31
Diella nga Peja .....	32
Abdyl Frashëri në Prizren .....	33
Dardani dhe Vlora .....	35
Era në Kosovë .....	36
Elegji e nënës për birin .....	37
Minatorët e Stari Tërgut .....	39
Dy gishtat "V" të kosovarëve .....	41
Lojrat e jetës .....	42
Te Poradeci .....	43
I ndershmi .....	45
Meditim .....	46
Manushaqja e Naimit .....	47

"Naimin nga Muzeu e dëbuan në Sarandë" .....	48
Lindja e djalit të parë .....	49
Balada e eshtrave .....	50
Maturantes me peliçe tigri .....	52
<b>11 motive gjermane:</b> .....	<b>54</b>
Napoleoni në sinfoninë e Bethovenit .....	55
Kupa e mbretit të Tulës .....	56
Peisazh gjerman .....	57
"Danubi Blu" .....	58
Zbulimi i Trojës nga Schlimani .....	60
Molla e "Vilhelm Telit" .....	61
Në banket me miqtë gjermanë .....	62
Procesion nderimi .....	63
Analogji .....	64
Gjermania në kohra .....	65
Alternativë .....	66
Takim në "Sokakun e të Marrëve" .....	67
Nënë Tereza .....	68
Në tren .....	70
Librat e grisur në fund të vitit shkollor .....	71
Vizion Palestine .....	72
Dallandyshtet .....	74
Shtëpia e poetit të burgosur .....	75
Te varri i nënës .....	77
<b>11 motive helene:</b> .....	<b>79</b>
Fqinjtit tim grek .....	80
Qilimi i Penelopës .....	81
Sokratit .....	82
Molla e Afërditës .....	83
Thundra e Akilit .....	84
Djepi i Homerit .....	85
Përballë përgjigjes .....	86

Përkthyesi .....	87
Refren për Kalin e Trojës .....	89
Ku-Ku, Çamëri! .....	90
Ftoi i fëmijërisë te dera .....	91
Qeni ynë Balo .....	93
Parku natën .....	95
Zogjtë .....	96
"Rrapi i Ismailit" .....	98
Në mes .....	100
Trungu i përzhitur .....	102
Letër Arben Brocit .....	103
Fëmija brenda shtatzanës .....	104
Gruas .....	106
Kur këndoi Arbëreshi .....	107
Shqiptari i Bregut .....	108
Këpucët e mia të grisura .....	109
<b>Motive gri:</b> .....	<b>111</b>
Gurët e Piramidës .....	112
✚ Në Parlament .....	113
Deputeti mumje .....	114
Hipokriti .....	115
✓ Variant karrieristi .....	116
Analogji .....	117
Kthesa talenti .....	118
Kritikut që të mbyl lëvdata .....	119
Hija e spiunit .....	120
Zogu .....	122
Emigrantja (Poemë) .....	123
Dhoma e gjumit .....	134
Te ullinjët e Vlorës ✚ .....	135
Njeriu .....	136
Vdekja .....	137
Ikim .....	140

Tirazhi 2000 kopje

Formati 600x880

Stazh 2204/82

Shtypur në Shtypshkronjën Ushtarake  
Tiranë, 1995



